



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
Up1 nr. 11-158
27.05.2022

Sh k u p

Bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në lidhje me nenin 141 paragrafi 13 nga Ligji, pika 8 nga Udhëzuesi për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 nga 20.10.2015, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.11-2054/1 nga 20.05.2022 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2108/5 nga 27.05.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në seancën e 21-të, e mbajtur më 27.05.2022, miratoi si në vijim:

Vendim
për vërejtje publike dhe
përgjashtim nga ritransmetimi i shërbimeve programore

- PUBLIKISHT PARALAJMËROHET:** Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për tregti, prodhim dhe shërbime ANTENA AS KTV import-eksport SHPKNJP Kërçov, sepse ka ritransmetuar shërbim programor që nuk janë të parapara në regjistrin e Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në pajtueshmëri me nenin 141 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.
Shkelja e paragrafit 1 e kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.11-2054/1 nga 20.05.2022, si pjesë plotësuese e vendimit si Shtojcë nr.1.
- OBLIGOHET:** Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për tregti, prodhim dhe shërbime ANTENA AC ATV import-eksport SHPKNJP Kërçov, menjëherë pas marrjes së vendimit duhet të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, pra të ndalojë ritransmetimin e shërbimeve programore.
- Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, veprimi sipas vendimit për vërejtje publike dhe për ndalimin e ritransmetimit të shërbimit programor.
- Pasi subjekti i mbikëqyrur i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, nuk veprimi sipas vendimit pra ka vazhduar të kryejë shkelje për të cilat është paralajmëruar publikisht, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuel në pajtueshmëri me nenin 23 paragrafi 1 alinea 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, ka paraqitur kërkesë për inicim të procedurës kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente.
- Ky Vendim është përfundimtar, dhe si ditë e miratimit të tij konsiderohet dita e verifikimit të tij në arkivin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

A r s y e t i m

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Agjencioni) në pajtueshmëri me nenin 6 paragrafi 1 alinea 4 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (LSHMAAV) morri masë në përputhje me ligjin për shkelje të dispozitave nga LSHMAAV ose rregulloret e miratuara në bazë të saj dhe kushteve e detyrimeve të parapara në leje.

Bazuar në nenin 28 nga LSHMAAV, Agjencia ka kompetenca të kryejë mbikëqyrje kontrolli (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që i transmetojnë operatorët e rrjetit publik të

komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave nga ligji, lejet, çertifikatat e lëshuara për regjistrim, respektimin e dispozitave të këtij ligji, aktet nënligjore dhe akte të tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave të saja ligjore, dhe në pajtueshmëri me nenin 27 dhe nenin 28 nga LSHMAAV, Agjencia më datë 20.05.2022., ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore ndaj programeve të ritransmetuara nga ana e Shoqëris për tregti, prodhim dhe shërbim ANTENA AC ATV eksport-import SHPKNJP Kërçov, ku u konstatua se operatori i cekur që sipas notifikacionit të Agjencisë për komunikim elektronik mund të ushtrojë veprimtarinë e tij në teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbim programor që nuk përfshihen në çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të lëshuara nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 nga LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë detajisht të specifikuara në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-2054/1 nga 20.05.2022., e cila është pjesë plotësuese e këtij vendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, në lidhje me nenin 141 paragrafi 13 nga Ligji, pika 8 nga Udhëzuesi për caktimin e afatit për veprim sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.11-2054/1 nga 20.05.2022., dhe Konkluzionin ark.nr. 02-2108/5 nga 27.05.2022., për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV të përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi vendim ndaj subjektit të përmendur më lartë për shqiptim të masës vërejtje publike dhe obligohet menjëherë pas pranimit të vendimit të ndërpresë ritransmetimin e shërbimeve programore dhe të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga LSHMAAV, në mënyrë që të ndërpresë ritransmetimin e shërbimeve programore.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i përmendur ka vepruar sipas urdhërit, për vërejtje publike dhe ka ndaluar veprimtarinë për ritransmetim të shërbimeve programore.

Në pajtueshmëri me nenin 24 nga LSHMAAV, ky vendim është përfundimtar dhe ndaj tij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik mund të ngrejë padi për fillimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padi për fillimin e kontestit administrativ paraqitet brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për shërbime mediatike
audio dhe audiovizuale,
Kryetar i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v

Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik mund të ngrejë padi për fillimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padinë për fillimin e kontestit administrativ duhet ta paraqesë brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark nr.11-2054/1 nga 20.05.2022.

Dorëzuar tek:

- Shoqëria për tregti, prodhim dhe shërbim ANTENA AC KTV import-eksport SHPKNJP Kërçov;
- Udhëheqësit/personit përgjegjës në Shoqërin për tregti, prodhim dhe shërbim ANTENA AC KTV import-eksport SHPKNJP Kërçov;
- Sektorit për planifikim strategjik dhe mbrojtjen e të drejtave autoriale;
- Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik;
- Personat e emëruar në Agjencin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për udhëheqjen e regjistrit Up1; dhe
- Agjencisë për komunikim elektronik të RMV-së.